



## PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e DISKUTIMIT PUBLIK

Për

### Qarkoren-Buxhetore 2023/01 – Granti për Arsim

Diskutimi publik i mbajtur me dt. 14.06.2022( e marte) në ora 14:00

Vendi : Salla e Kuvendit në objektin e Komunës.

Diskutimi Publik u organizua nga Kuvendi i Komunës së Deçanit përmes grupit punues në përbërje : 1.Floriana Hulaj (AAK), 2.Arjan Dobraj(AAK), 3.Elmedina Sadikaj (AAK), 4.Sylejman Lokaj (LDK), 5.Valiant Mataj (LVV),ndërsa takimin e udhëhoqi, kryesuesi i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.

Ky diskutim publik ka qenë i hapur për të gjithë qytetarët e komunës së Deçanit, shoqërinë civile, gazetarët etj.

Në takim kanë marrë pjesë gjithsejt 44 pjesëmarrës ( 35 meshkuj dhe 9 femra), Drejtoresha e drejtorisë për Buxhet dhe Financa, znj.Dafina Cacaj, Drejtori i drejtorisë për Arsim, z.Bekim Vishaj, drejtor të shkollave dhe qytetarë.

Drejtoresha e Buxhetit, znj.Dafina Cacaj, sqaron rreth Qarkores së parë buxhetore, ndërsa drejtori i drejtorisë për Arsim, z.Bekim Vishaj, ka dhënë sqarime të hollësishme rreth funksionimit të arsimit në komunën tonë dhe sfidat me të cilat po përballemi, kryesisht si rrjedhojë e rënies së numrit të nxënësve.

Kërkesat kryesore ishin për rregullim të objekteve shkollore si dhe paisje të shkollave.

Deçan, dt.14.06.2022

Procesmbajtëse:  
Dyke Llolluni

